



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VIII**

Sesioni pranveror

**Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport**

Mbledhja nr.30

Prishtinë, më 24.5.2022, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Ardian Gola, kryetar, Albena Reshitaj, Enis Kervan, Arijeta Rexhepi, Arjeta Fejza, Eliza Hoxha, Vlora Dumoshi dhe Jasmina Dediq.

**Munguan:** Jahja Kokaj, Adriana Matoshi dhe Ardian Kastrati.

**Të ftuar:** Osman Buleshkaj, këshilltar- GIZ, Rrezearta Zhinopotoku dhe Lirie Lokaj - GIZ.

**Përfaqësues të tjerë:** Doresa Deliu, KDI dhe përfaqësues të mediave.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

**Mbledhjen e kryesoi:** Ardian Gola, kryetar i Komisionit.

**Për këtë mbledhje u propozua ky**

**Rend i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës.**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me 10.5.2022;**
- 3. Prezantim me temë: Sistemi i Arsimit Parauniversitar në Kosovë, nga Osman Buleshkaj, këshilltar i GIZ;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

## 1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

## 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 10.5.2022

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 10.5.2022, u miratua pa vërejtje.

## 3. Prezantim me temë: Sistemi i Arsimit Parauniversitar në Kosovë

**Ardian Gola**, tha se e kemi ftuar z. Osman Buleshkaj, këshilltarin nga organizata GIZ, , për prezantimin e temës Sistemi i arsimit parauniversitar në Kosovë.

**Osman Buleshkaj**, tha se gjatë prezantimit do të theksohen disa prej sfidave dhe pikave strategjike, ku Komisioni do të mund ti përfshijë në raport me ndryshimet e nevojshme ligjore. Në vijim ceku ndarjen sipas niveleve të arsimit në Kosovë, që fillon me edukimin parashkollor (ISCED 0 - moshë - 6 vjeç, niveli ISCED 1 që përfshin klasat 1 - 5 dhe më tutje arsimit mesëm i ulët – ISCED 2 (klasat 6 - 9) dhe arsimit mesëm i lartë ISCED 3 (klasat 10 - 12).

Në arsimin e lartë ISCED 5-8; përfshihet cikli i arsimit të lartë (5) – si pjesë e kolegjeve të specializuara të biznesit të cilat ofrojnë një kualifikim pas shkollës së mesme, niveli Bachelor (6), niveli Master (7) dhe nivelin Doktoratë (8).

Sa i përket edukimit në fëmijëri të hershme, e kemi një legjislacion jo të plotë për këtë nivel të arsimit, ekziston një dokument që quhet Standardet e Zhvillimit të të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme, të cilin shumica e institucioneve të këtij niveli të arsimit e përdorin si bazë të programeve. Jemi vendi me shkallën më të ulët të pjesëmarrjes së fëmijëve në edukimin parashkollor me një pjesëmarrje prej vetëm 19.5%. Grupmosha 0-5 merr pjesë vetëm me 6.7% në edukimin parashkollor. Në klasat parafillore, moshë 5 deri më pak se 6 vjeç, kemi një përfshirje prej më pak se 88%. Mesatarja e OCED është mbi 87% për fëmijët e grupmoshave 3 deri në 5 vjeç dhe 36% për fëmijët 0 deri në 2 vjeç.

Për fëmijët 0-3 vjeç, pjesëmarrja vazhdon të mbetet shumë e ulët, prej më pak se 3755 fëmijë që janë të regjistruar në IP publike dhe private. 9 nga 10 fëmijët e moshës 3-4 vjeç nuk marrin pjesë në programet parashkollore të organizuara dhe të licencuara. Fëmijët nën 5 vjeç të zonave rurale janë të përfshirë në EFH (Edukimi në Fëmijëri të Hershëm) tre (3) herë më pak se bashkëmoshatarët e tyre në zonat urbane, për shkak se këto shërbime në zonat rurale pothuajse nuk ekzistojnë fare.

Në zonat urbane kemi një përfshirje prej 25% në programe të EFH, ndërsa në ato rurale vetëm 7.9% mund t'i marrin këto shërbime. Shkollat fillore janë ofruesit më të mëdhenj të EFH, të cilat e ofrojnë edukimin parafillor (klasa 0) për fëmijët 5 vjeç, në të cilën në vitin shkollor 2020/21 kanë qenë gjithsej 22,086 fëmijë të moshës 5-6 vjeç ose 93.1% ndjekin klasat parafillore në kopshte (2888 fëmijë) dhe shkolla (19198 fëmijë).

Nga të dhënat e SMIA-s, 2128 fëmijë të moshës 0 - 5 vjeç përfitojnë shërbime në institucione private. Ekziston një hendek i madh i të dhënave se sa fëmijë ndjekin institucionet private; sa në ato private të licencuara dhe sa në ato të pa licencuara. Deri në qershor të vitit 2021, janë të

licencuara gjithsej 177 IP (Institucione Parashkollore) private. Ndërsa, numri i IP private të palicencuara vlerësohet të jetë 250. Në këto institucione ofrohen tekste dhe materiale, mirëpo jo të përshtatura me moshën. Në të gjithë nivelin parafillor, në shkollë dhe disa kopshte, është ofruar një pako prej pesë tekstesh shkollore për vitet shkollore 2018/19 dhe 2019/20. Mirëpo, vitin e kaluar është konsideruar se kjo pako shkon përtej kësaj grupmoshe dhe nuk është shpërndarë. Ka mungesë të infrastrukturës së përshtatshme për përfshirjen e kësaj grupmoshe në edukimin e fëmijërisë së hershme, gjithashtu mekanizmat e financimit, edhe sektorin e shëndetësisë, edhe sektorin e mirëqenies sociale – por edhe Ministrinë e Arsimit, prandaj ende mbetet sfida integrimi dhe koordinimi i këtyre sektorëve. Më shumë sesa për infrastrukturë të re, kemi nevojë për përshtatje të hapësirave ekzistuese shkollore në vendet ku nuk ka numër të mjaftueshëm të nxënësve të klasave 1-9, për nevoja të edukimit të fëmijërisë së hershme. Jo gjithmonë kemi nevojë për objekte të reja. Ende nuk kemi kurrikul për këtë moshë dhe as plan zyrtar, i cili do të drejtonte gjitha IP-të që ofrojnë programe që të lidhen në një kornizë të përbashkët të kurrikulës për këtë grupmoshë.

Në arsimin e përgjithshëm parauniversitar, janë Ligji për arsimin parauniversitar (2011) Ligji për arsim në komuna (2008); Ligji për Inspektoratin e Arsimit (2018) Ligji për provimin e Maturës (2016); Ligjin për tekste shkollore (2007) dhe një dokument që quhet Korniza Strategjike për Zhvillimin e Mësimdhënësve, që e rregullon ligjërisht karrierën e mësimdhënies nga përfundimi i studimeve themelore deri në fazat e licencimit dhe avancimit në karrierë.

Nëse flasim për përfshirjen dhe pjesëmarrjen në arsim parauniversitar, sipas statistikave të MASHT-it, të vitit 2020-21, përfshirja e fëmijëve në arsimin parafillor (klasa 0) është 88.1%, me një rënie prej 5% nga viti paraprak.

Në arsimin e mesëm të ulët, përfshirja është 91.2%, me një rënie prej 0.1% dhe arsimin e mesëm të lartë është 81.1%, me një rënie prej 4.3%. Shkalla e përfshirjes në arsimin fillor (klasa 1-5) është 101.2%, duke shënuar rritje prej 0.6% nga viti paraprak. Vazhdojmë të kemi përfshirje të ulët të fëmijëve nga komuniteti RAE, ku vetëm 7.6% (nga 15% të fëmijëve në këtë grupmoshë) marrin shërbime në nivelin parashkollor, ndërsa në nivelin e mesëm të lartë vetëm 31% (nga 85%) të nxënësve marrin pjesë.

Sa i përket sfidave kryesore të Arsimit Parauniversitar ato janë: cilësia në arsimin parauniversitar; Kurrikulat, Kapacitetet e Mësimdhënësve; Tekstet Shkollore dhe Rrjeti i Shkollave. Kur flasim për cilësinë në arsimin parauniversitar, e kemi një kornizë ligjore për sigurimin e cilësisë në arsim parauniversitar, mirëpo, asnjëherë nuk është kompletuar kuadri i inspektorëve pedagogjikë, që është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe mbështetjen e kësaj komponente.

Një element tjetër në menaxhimin e arsimit është rekrutimi i drejtorëve në institucionet e arsimit edukative-arsimore dhe aftësuese, ende përcillet me sfida të shumta. Ende nuk kemi një politikë e cila e rregullon karrierën e drejtorëve, sepse me përfundimin e mandatit të drejtorit, nuk ka mundësi më të avancimit tutje. Nuk ka politikë arsimore që një drejtor të mirë shkolle e ndërlihdë me pozita drejtuese në nivel komunal, regjional apo qendror.

Sa i përket vlerësimeve, vazhdojmë të organizojmë dy teste të jashtme, që janë testi i arritshmërisë dhe kalueshmërisë apo i maturës, ku sfida mbeten, administrimi dhe mungesa e kapaciteteve (Qendra për Vlerësim). Ekziston një sistem për mbledhjen e të dhënave dhe statistikave në arsim, SMIA në MASHT, por nuk ofron të dhëna të përgjithshme sa i përket arsimit sepse nuk është e

lidhur me sistemet tjera apo me bazat e të dhënave tjera konkretisht me bazën e të dhënave të zhvillimit profesional të mësimitdhënësve.

Sa i përket kurrikulës të bazuar në kompetenca, jemi në vitin e dhjetë, nëse i kombinojmë të dyja – edhe pilotimin edhe periudhën e zbatimit të saj. Cikli i zhvillimit të kurrikulave lëndore ka përfunduar vitin e kaluar, klasa e pestë. Dhe tani në tërë sistemin kemi zbatimin e kurrikulës së re, ku janë trajnuar 24.000 mësimitdhënës, mirëpo, në 4/5 vitet e fundit janë 4-5 sfida kryesore me të cilat përballet kjo komponentë e arsimit, siç janë: qasja e fragmentuar dhe jokoherente e zbatimit të elementeve të reformës kurrikulare; moskonsolidimi i mekanizmave të mbikëqyrjes, përkrahjes dhe llogaridhënies në procesin e zbatimit të kurrikulës - ku kemi një shpërputhje të komunikimit mes palëve (atij komunal dhe qendror) në zbatimin e reformës kurrikulare; orientimi dhe përkrahja e pamjaftueshme e mësimitdhënësve dhe shkollave në planifikimin dhe realizimin e vlerësimit të nxënësve bazuar në kompetenca – pasi që nuk mjaftojnë trajnimet gjashtë ditore që i ofron MASHT-i shfrytëzimi i pamjaftueshëm i autonomisë së shkollave për zbatimin e kurrikulës, në përputhje me kushtet dhe specifike dhe nevojat e nxënësve etj.

Sa i përket mësimitdhënësve, ne vazhdojmë të ofrojmë programe trajnime për mësimitdhënës pa shkëputje nga puna. E kemi një sistem të licencimit të mësimitdhënësve që i bashkon tri elemente: marrja e licencës pas një viti përvojë pune me një kontratë të rregullt; mirëmbajtja e asaj licence, që implikon vlerësimin e performancës të mësimitdhënësve sipas ligjit për arsim parauniversitar, një herë në pesë vite gjatë shërbimit; gradimi i mësimitdhënësve i cili duhet të bazohet në performancën e mësimitdhënësve dhe politikë e cila fillimisht është shkruar në vitin 2012, dhe pastaj është ndryshuar në vitin 2015, edhe një herë në vitin 2017 – ajo asnjëherë nuk zbatohet si e tërë. Vlerësimi i performancës së mësimitdhënësve nuk është duke u zbatuar. Sipas raporteve të MASHT-i, Inspektoriati i Arsimit (IP) deri në mars 2020 ka vlerësuar 755 mësimitdhënës. Përfshirja e mësimitdhënësve në Zhvillim Profesional (ZHP) në vitin 2019 ka qenë 24.7%. Kjo shkallë është dukshëm më e ulët sesa në vitin 2015, ku kjo shkallë ka qenë 54%. Të dhënat për trajnime nuk sigurohen përmes softuerit për licencimin e mësimitdhënësve në MASHTI.

Sa i përket teksteve shkollore, me gjithë përpjekjet e MASHT-it, nuk ka arritur të mbështesë procesin e hartimit/rishkrimit të teksteve sipas dinamikës së shtrirjes së zbatimit të kurrikulës. Janë hartuar dhe miratuar teksteve të reja shkollore, mirëpo, janë raportuar shumë ankesa në lidhje me cilësinë e tyre. Sfidë kryesore e procesit të hartimit të teksteve të reja shkollore mbetet pjesa e vlerësimit të teksteve, përzgjedhja e recensentëve si dhe mungesa e mekanizmit të përgjegjësive për cilësinë e atyre teksteve. Është një projektligj që synon të përmirësoj procesin e hartimit të teksteve shkollore – i cili është në diskutim paraprak.

Sa i përket rrjetit të shkollave, statistikat po tregojnë se çdo vit kemi rënie të nxënësve në arsimin parauniversitar. Për dhjetë vite, 2012-2022, kemi rënie prej njëqindmijë (100.000) nxënësve – nga 450.000 nxënës në rreth 350.000. Vazhdojmë të kemi të njëjtin numër të mësimitdhënësve dhe numrin e njëjtë të rrjetit të shkollave, edhe pse aktualisht 60% të shkollave kanë më pak se 250 nxënës. I kemi mbi 200 paralele te ndara, të cilat funksionojnë me më pak se 50 nxënës; që i bie se janë vetëm 4 nxënës në një klasë. Planifikimet sesi do të organizohet rrjeti i shkollave duhet të bëhet duke pasur parasysh implikimet që ka investimet që janë bërë dhe si të ruhet dhe e dyta, mësimitdhënësit të cilët i kem, për të cilët kem obligim që t'i ruajmë dhe t'i riorientojmë në funksion të përshtatjes më të mirë në një rrjet më të mirë. Disa prej rekomandimeve janë: Fuqizimi i kapaciteteve për menaxhim të shkollës – ku nuk do të kemi një shkollë të mirë derisa nuk kemi një

sistem të mirëfilltë të përzgjedhjes së drejtorëve dhe sigurimit të karrierës në pozitë udhëheqëse, e cila duhet të përcillet me një llogaridhënie të shtuar; Infrastruktura shkollore duhet ta përfshijë komponentin e digjitalizimit – ku kemi nevojë për përmirësim të shkollave ekzistuese; Zbatimi i kurrikulës dhe Administrimi i testeve kombëtare dhe ndërkombëtare – ku ne nuk kemi ende një Qendër për Vlerësim; Rishikimi i rrjetit të shkollave në përputhje me trendët, statistikën dhe nevojat lokale.

Gradimi nënkupton pozitë më të mirë dhe pagë më të mirë në bazë të performancës. Sipas projekcionit të popullsisë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), parashikohet rënie për çdo vit të numrit të fëmijëve të grupmoshave 0-4 dhe 5-9 vjeç; ku çdo vit kemi hyrje më të vogël të nxënësve të këtyre grupmoshave, dhe rrjedhimisht nevojë më të vogël për objekte të reja të shkollave dhe rekrutim të numrit të mësimit të nxënësve. Trendi i njëjtë na ka përcjellë edhe në arsimin e lartë, ku kemi rënie të numrit të studentëve në Institucione të Arsimit të Lartë. Në vitin akademik 2015/16, kemi pasur 130.000 studentë, kurse vitin e kaluar akademik kemi pasur 95.000 studentë, sipas SMIA, përfundoi ai.

**Eliza Hoxha**, tha se shumë prej nesh punojnë në arsim por nuk kemi qasje në të dhëna të tilla dhe këto informacione na shërbejnë në veprimet që duhet t'i ndërmarrim. Plot prej problemeve në kuptimin praktik janë të njohura nga diskutimet dhe sfidat që i kemi në familje – me fëmijët, me çerdhet dhe shkollat por edhe në universitet. Por desha me u ndal tek dy çështje, përtej çdo aspekti teknik që kemi (qoftë në aspektin e legjislacionit, organizimit, digjitalizimit etj.): Parametrat demografik - ku do të ndalesha tek aspekti i lindshmërisë, i cili është në rënie rapide dhe lëvizshmërisë brenda dhe jashtë territorit, nga zonat rurale në zonat urbane. Meqë vij nga fusha e arkitekturës dhe urbanizimit, në krejt teoritë më të freskëta të zhvillimeve urbane, thuhet se deri në vitin 2050 popullsia botërore do të jetë 80% popullsi urbane, që i bie se presion kryesor për shërbime arsimore do të jetë kryesisht në zonat urbane.

Nuk do të pajtohesha 100% me idenë se nuk kemi nevojë për shkollë të reja, kemi nevojë më shumë për shkollë urbane dhe për transformim të hapësirave në zonat rurale në diçka tjetër, që mund të jenë për çështje joformale edukative, kulturore apo çfarëdo që mendohet në një strategji të arsimit nesër.

Në rastin e komunës së Fushë-Kosovës, ka trysni jashtëzakonisht të madhe për çerdhe dhe po ashtu për staf shtesë dhe nuk kanë mundësi të punësojnë për shkak të një kuote në Ministrinë e Arsimit që ka për bazë numrin e popullsisë, që është regjistruar shumë më herët, prandaj janë probleme të implikuara të cilat e diktojnë edhe investimin kapital dhe shpërndarjen e këtyre shërbimeve. Korniza ligjore dhe licencimin, pre mua ka qenë një brengë e jashtëzakonshme ideja që të tentohet që cilësia të matet me prezencën dhe kartelat digjitale, sepse në raste të caktuara dhe profesione të caktuara që e kanë pjesën praktike, ka krijuar probleme të jashtëzakonshme. Dhe tentativa që zakonisht me idenë e abuzimit në punë ose mospraninë në punë, të shkohet me teknikalitete të skajshme i ka ngulfatur disa shërbime arsimore që lidhen me pjesën praktike. Ligji për profesionet e rregulluara faktikisht i prek të gjitha sferat, edhe në pjesën e shërbimeve arsimore edhe në pjesën kur dalim nga ato shërbime dhe bëjmë pjesën tone profesionale dhe praktike – e që duhet të kalojmë në fazën e licencimit pa dallim, ku përfshihen gjithë mësimit dhe edukatorët, parcialisht e dimë që bëhet për disa profesione, mirëpo në kuptimin e përgjithshëm nuk e di se sa zbatohet.

**Osman Buleshkaj**, tha se ligji parasheh themelimin e Qendrës për Testim, ku parashihet provimi i profesionit dhe po të zbatohet ky ligj dhënia e licencës do të rregullohet. Në dy vitet e fundit janë përgatitur disa udhëzime administrative që e mundësojnë zbatimin e këtij ligji që mësimdhënësit të vlerësohen njësoj, sikurse profesionet tjera.

Tek profesioni i mësimdhënies, ligji ta jep mundësi organizimin e praktikës tre deri në gjashtë muaj. Praktikisht kur një mësues zgjidhet nga DKA-ja, e ka një kontratë njëvjeçare provuese të praktikës dhe t'i nënshtrohet mandej provimit profesional që do të testonte (vlerësonte) njohuritë e përgjithshme akademike.

**Arjeta Fejza**, tha se beson që raporti është i plotë dhe i ka prekur sfidat kryesore që ballafaqohet arsimit parauniversitar. Tek rrjeti i shkollave, besoj që mbetën disa sfida për funksionim më të mirë të qendrave burimore dhe mësimore. E këto dy kategori prekin boshtin e arsimit parauniversitar, që është gjithëpërfshirja, veçanërisht kur flasim për fëmijët me nevoja të veçanta dhe fëmijët e komuniteteve. Fëmijët me nevoja të veçanta dhe të komuniteteve kanë shumë vështirësi me i zhvillu aftësitë didaktike.

Sfidë tjetër është njëfarë hutie e fëmijëve tanë në aspektin e përzgjedhjes të kalimit nga niveli i ulët në atë të mesëm kur aplikojnë për gjimnaz apo shkolla të mesme profesionale, aty informohen për lëndët të cilat janë të nevojshme për pranim. Planifikohet që vitin e ardhshëm të kemi këshilltarët e karrierës, të cilët do të punojnë me nxënësit në orientimin e drejtimeve që ata do përzgjedhin në shkollë të mesme. Nga vizitat në komuna, sfidë mbetet dualizmi ligjor sa i përket procesit të rekrutimit të mësimdhënësve. Kemi ngecje në implementimin e numrit të psikologëve të planifikuar nga niveli lokal.

Duhet të ketë një fuqizim të bashkëpunimit të shkollave me aktivet profesionale, të cilat do të mund të jepnin një kontribut sa i përket teksteve shkollore dhe metodave me të cilat do të mund të zbatohet kurrikula, siç është implementimi i planeve javore të cilën e parasheh kurrikula e Kosovës dhe e cila mbetet shumë sfiduese për aktivet. çështja e licencimit mbetet sfiduese, dhe e vërteta është për një proces tepër formal.

**Osman Buleshkaj**, sa i përket rrjetit, ne kemi pesë qendra burimore dhe arsimore. Mirëpo, qendrat arsimore veprojnë në bazë të shkollave ekzistuese por edhe me bazë në komunitet, ku ofrojnë mësim shtesë apo plotësues. Kemi 204 punëtorë që punojnë në qendra burimore. Nëse i shtohen dhe asistentë për fëmijë me nevoja të veçanta ky numër do të bëhet diku 700 deri 800. Qendrat mësimore financohet prej shtetit (qeverisë), mirëpo edhe prej burimeve tjera financuese. Ekziston një mekanizëm që na bën filtrimin se kush mund të ofrojë këto shërbime.

Dualizmi ligjor është një problem faktik që na del tek DKA-të, kur kemi një proces rekrutimi të mësimdhënësve dhe drejtorëve. Nëse dikush parashtron ankesë, nuk e dimë në cilin ligj bazohet. Pse duhet dikush të jetë kryesues i aktivitetit profesional brenda shkollës, kur nuk vlerësohem dhe në fund të ditës jam njëjtë sikurse tjetri. Cili është stimulimi, i cili jo gjithnjë duhet të jetë stimulim financiar. Më herët thamë lidhja me karrierën do të ishte një zgjidhje. Zbatimi i politikës së kurrikulës ka vuajtur edhe për shkak të kësaj, pra stimulimit, tha ai.

**Arijeta Rexhepi**, kërkoi sqarim lidhur me nivelin ISCED katër, i cili ju mundëson një punësim më të shpejtë të rinjve, a ka ndonjë të dhënë se sa nxënës përfshihen tek ky nivel, profilet arsimore që ndiqen dhe numri i tyre që punësohen. Të fëmijët 0-3 vjeç, e përmendet që nuk keni kuadër të mjaftueshëm për këtë nivel shkollimi, nga komuna e Gjilanit ndërtimi ose improvizimi i një çerdhe në një fshat është i domosdoshëm por e kemi menduar që të bëhet një hulumtim se a do ketë fëmijë, në to. Sa i përket cilësisë në arsimin parauniversitar, testet e klasës së 9-të edhe të 12-të nuk përdoren për reforma cilësore, kërkoi krahasimin e notës që nxënësi e merr në testin e jashtëm me notën që është vlerësuar nga mësimdhënësi i shkollës për lëndën apo lëndët përkatëse. Sa i përket kurrikulës, ajo pyeti se a kanë të gjitha shkollat në Kosovë koordinatore të cilësisë. Sa i përket teksteve shkollore, llogaridhënia në hartimin e teksteve shkollore është shumë e rëndësishme. Mirëpo kemi një lëvizje në këtë drejtim, pasi mësimdhënësit këtë vit kanë pasur mundësinë e përzgjedhjes së teksteve shkollore. Është e domosdoshme rritja e numrit të inspektorëve arsimorë. Shumica prej tyre kanë inspektor pedagogjik, mirëpo jo ekspert.

**Vlora Dumoshi**, tha se bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare veçanërisht në fushën e arsimit ka pasur një rol shumë të rëndësishëm që nga periudha e pasluftës, e që ngritja e kapaciteteve njerëzore në sistemin arsimor bëhet përmes organizatave si GIZ-i dhe të tjera, brenda një institucioni arsimor e vlerëson kontributin dhe të gjitha hulumtimet dhe politikat bëhen në të mirë të ngritjes së kapaciteteve për arsim.

**Eliza Hoxha**, kur u fol për vlerësimin, faktikisht çdo vullnet i mirë për punë shtesë ose kontribut shtesë brenda një institucioni arsimor asnjëherë nuk vlerësohet, këtu është ideja se si do të duhej të ngritet performanca dhe cilësia, kur të riaplikon për vendin tënd të punës, duhesh t'i posedosh një mal me letra të cilat asnjëherë nuk janë në data bazat e institucionit ku ti punon. Kur jemi tek sistemi ynë janë vetëm këto "tikat" e kërkua me ligj, qoftë një licencim, trajnim, certifikatë. Prandaj nuk mundemi asnjëherë të shohim performancën e dikujt që gradualisht shkon kah menaxhimi, sepse ka aftësi dhe shkathtësi të tilla ekstra-kurrikulare. Dhe në vend se të stimulohen të tillët të kalohen në stadi tjera të avancimit, ne i mbysim në teknikalitete. A ka një model në sistemin tonë arsimor, se si ishte dashur të rregullohet kjo çështje – përtej "tikave" dhe boksave tekniko-formale për plotësim.

**Osman Buleshkaj**, roli jonë si organizata dhe si mbështetës është ofrimi i të dhënave sa më reale për situatën që politikbërësit t'i kenë në dispozicion për politika më të mira. Arsyeja pse 9 nga 10 fëmijë nuk vijnë pjesëmarrjen në edukimin e fëmijërisë së hershme, është punësimi i prindërve – ku së paku njëri nga prindërit është në shtëpi dhe rrjedhimisht nuk ka motivacion për dërgim të fëmijës në kopsht. Dërgimi i fëmijës në kopsht kërkon kosto shtesë, si ai i transportit dhe të tjera. Për çështjen e testeve të klasës së 7-të ekzistojnë vlerësime të vazhdueshme kurrikulare. Mirëpo, shkollat duhet të organizojnë teste të shkallës në përfundim të klasave (kemi edhe testime të klasave të dyta), për vlerësime të brendshme e personalisht e mbështes idenë e karrierës dhe ngritjes në karrierë të një mësimdhënësi. Duhet të ketë shkallë të ngritjes në karrierë, që një mësimdhënësi fillestar e bëjnë edhe drejtor shkollor por edhe drejtor komunal të arsimit, ndoshta edhe Ministër të Arsimit.

**Albena Reshitaj**, tha se është e vërtetë që na mungojnë hulumtimet e mirëfillta për çdo temë dhe institucion, sidomos sa i përket arsimit parauniversitar. Dua të fokusohem tek dy çështje rreth materialit që e keni përdorë për hulumtim dhe periudhën (kohën) për të cilën është bërë ky hulumtim, a keni vërejtur që ekziston ndonjë monitorim apo njësi matëse në nivel të arsimit parauniversitar në Kosovë dhe a është duke u punuar në drejtim të finalizimit të ligjit për EFH që duhet të ketë dhe pjesën e zhvillimit psikologjik dhe social të fëmijëve, sepse nuk besoj shume tek këto vlerësimet e PISA-s?

**Osman Buleshkaj**, kjo është një përmbledhje e shkurtë prej analizës së gjendjes që është bërë për planin strategjik të arsimit, strategjinë e re 2022-2026, që shpejt do të dal në diskutim publik.

**Rrezearta Zhinopotoku**, është e vërtetë që shumë shpesh themi se nuk kemi të dhëna të mirëfillta, mirëpo nuk është shumë e vështirë që këto të merren të fragmentuara dhe me e pa që e kemi një trend. Testi i klasës së pestë, apo i arritshmërisë bëhet me një mostër reprezentative (përfaqësuese), jo me individë sepse nuk ka impakt individual. Në vitin 2014/15, pak para testimit të PISA-s, situata në terren që MASHT-i vetëm e bëri një vlerësim të klasës së pestë, në rezultatet e përgjithshme, ka dalë që fëmijët deri në klasën e 5-të vlerësohen me dy nota më të larta sesa është me të vërtetë performanca e tyre. Pra në mesatare, te nxënësit deri në klasën e 5-të i kemi me notën 3, jo me notën 5. Ky ka qenë një studim i brendshëm. Më tutje, kemi biseduar me drejtorët e shkollave, me drejtorët e DKA-ve, edhe me kryetarët e komunave. Rezultatet e klasës së 9-të, të testit të semimaturës na tregojnë të njëjtin trend. Të njëjtin trend na tregojnë edhe rezultatet e testit të maturës. Në programet që i kemi bërë në Zhvillim Profesional të Mësimdhënësve (ZHPM), në marrëveshje me MASHT-in jemi dakorduar që mësimdhënësit mos të certifikohen pa e dhënë një përkushtim gjatë trajnimit. E kemi zhvilluar një test të brendshëm, për programet në matematikë dhe kryesisht në shkenca të natyrës, që ka shërbyer si sinjal për kalimin apo jo të trajnimit. sipas këtij trendi, me rezultatet në testim të një nxënësi në klasën e 5-të, ne e dimë saktë se si do të performojë ai deri në klasën e 12-të, në testin e maturës. Kemi pasur testin e PISA-s, nuk kemi pa asnjë iniciativë për ta ndryshuar gjendjen. Ky sistem i joni nuk është duke ju mundësuar fëmijëve në zhvillimin e mendimit kritik dhe të bëhen zot të vetvetes.

Një konferencë për financim e arsimit është treguar që sa më herët që financohet dhe investohet në arsim, ajo kthehet shumëfish më tepër dhe investimet në nivele më të larta. Ligji për Arsimin për Fëmijërinë e Hershme dhe Ligjin për Tekste Shkollore, janë dy ligje shumë të rëndësishme që do të ndikojnë shumë në rritje të cilësisë.

**Osman Buleshkaj**, tha se Education 2030 e BE-së e parasheh tetë (8) kompetencat dizajnuara nga UNESCO, të promovuara në sistemet e arsimit në vendet e BE-së, ne i kemi fuzionuar në gjashtë (6) kompetencat kurrikulare janë në përputhje me trendët evropiane dhe përkojnë me nevojën për përgatitje të nxënësve për një treg pune ose për jetë dhe punë. Nuk e kemi krijuar mekanizmin e mirëfilltë për zbatimin e asaj që e kemi shkruar. Tekstet reflektojnë kurrikulën, por jo kapacitetin e mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës. Kapacitetet e tyre nuk i kemi ngritur në nivelin për të zbatuar kurrikulën me kaq kërkesa të mëdha.



**Ardian Gola**, duke falënderuar të ftuarit nga GIZ-i për shpalosjen e gjetjeve të prezantimit, e shpalli të mbyllur këtë mbledhje të komisionit.

#### **4. Të ndryshme**

Në këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 12:15.

*E përgatiti:*  
*Stafi mbështetës i Komisionit.*

**Ardian Gola,**  
-----  
**Kryetar i Komisionit**